




Projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



EFEKTE FINANCIARE TEK TAKSAT VENDORE



EFEKTE FINANCIARE TEK TARIFAT



PËR MË SHUMË INFO MBI PËRMBAJTJEN E RAPORTIT, KOMUNIKO ME KOORDINATORIN RAJONAL

[Kliko këtu](#)

Aspekte Financiare: Nga 61 bashki të vendit, rreth 21 kanë ndërmarrë ndryshime në paketën fiskale. Efekti financiar i përlogaritur për 17 bashki të observuara gjatë periudhës së pandemisë (të shprehura në grafikët më poshtë) është 282 milionë, ku 84% vjen si pasojë e ndryshimeve në tarifa dhe 16% pasojë e ndryshimeve në taksa. Është vënë re se mungojnë në përgjithësi detaje të metodës së parashikimit. Lehtësimin më të lartë financiar e vëmë re tek Kamza, Shijak, Maliq, Lezha dhe Elbasani. Impakti më i madh nga shtyrja apo ulja e nivelit të taksës ka ardhur prej tatimit mbi pasurinë e paluajtshme dhe taksa e biznesit të vogël, ndërkohë që ndër tarifat vendore më e afektuara është ajo e shërbimeve publike. Kryesisht nga tarifat pjesa më e konsiderueshme e uljes kanë përfituar si familjet ashtu dhe bizneset.


45 KËSHILLA BASHKIAK

U përgjigjën me masa ndaj dhunës në familje gjatë emergjencës COVID-19
Përmes aprovimit të rezolutës për monitorimin e dhunës në familje



Asistencë teknike nga Bashki të Forta


BtF mbështeti këshillat bashkiake për rritjen e njohurive për monitorimin e nismës në dy Webinare të organizuara në bashkëpunim me ASPA.



Të dhëna nga pyetsori online mbi çështjen e dhunës në familje

Dijeni mbi situatën

Këshilltarët bashkiakë si përfaqësues të qytetarëve kanë dijeni për situatën e dhunës në bashki



Njohje e mekanizmave

14% e këshilltarëve njohin mekanizmat mbrojtës që me ligj duhet të ngrihen nga pushteti lokal për të reaguar ndaj dhunës

636 VENDIME TË KËSHILLIT BASHKIAK


Periudha 15 MARS- 8 MAJ



Këshillat bashkiakë morën **168 vendime** që adresonin masa situatën e krijuar prej Covid-19



41 VKB u morën për të krijimin e lehtësirave fiskale mbi taksat dhe tarifatat lokale për bizneset, banesa sociale etj



127 V.K.B të tjera me qëllim dezinfektimin, rialokime buxhetore, ndihmë ekonomike, amendime kontrate etj. u miratuan për t'i bërë ballë Covid-19

Ky raport merr në konsideratë të dhëna të përftuara gjatë periudhës së mbylljes 8 javore në Shqipëri si pasojë e Covid-19. Të dhënat financiare flasin për 21 bashki, ndërsa grafiku i vendimeve bashkiake i përket periudhës 15 mars- 8 maj. Seksioni **Digjitalizimi në kohën e Covid-19** i referohet të gjithë periudhës që nga fillimi deri në 15 Maj. Seksioni i **Turizmit, Drejt Hapjes dhe Emergjencës Civile** i referohet periudhës nga java e 5-të deri më sot.

DIGJITALIZIMI NË KOHËN E COVID-19

E-Transparenca: Paçka se masat shtrënguese të Covid-19 impaktuan mënyrën e ushtrimit të funksionimit të bashkive, përdorimi i mjeteve të teknologjisë së informacionit mundësoi hedhjen e disa hapave të rëndësishëm në afrimin e institucionit të bashkisë me qytetarët. Bashkitë përdorën më së shumti median sociale facebook (61 Bashki) dhe pjesërisht websitet e tyre dhe median lokale për të informuar mbi masat që po merreshin për të administruar situatën. Bashki si Shkodra, raportuan në format më të strukturuar çdo ditë mbi aktivitetin e tyre gjatë COVID-19.

E-Pjesëmarrja: Në Elbasan administrata bashkiake dhe këshilli bashkiak në 12 Maj zhvilluan një diskutim live në Zoom me studentë të fakultetit Ekonomik të Elbasanit mbi Raportin e Performancës 2019. Ky diskutim u transmetua live në faqen e FB të Kryetarit të Bashkisë dhe Bashkisë, i cili mori dhe disa pyetje drejtpërdrejtë nga qytetarët që po e ndiqnin diskutimin në këtë platformë. Gjithashtu Bashkia bëri publik një pyetësor elektronik drejtuar publikut mbi aspekte të performancës bashkiake. Ky format diskutimi me pjesëmarrje nga publiku, mendohet të realizohet edhe nga bashki të tjera të asistuar nga Bashki të Forta. Transmetimi i drejtpërdrejtë në media sociale ka mundësuar mbi 100 komente nga qytetarët për administratën bashkiake apo për këshillin bashkiak.

E-Monitorim: Administrata bashkiake përdori formularë online të përgatitur nga Ministria e Brendshme për monitorim të shpërndarjes së ndihmës në fazën e parë të emergjencës (pilotuar fillimisht në Korçë) e më pas kudo. Në javën e dytë të majit ka nisur përgatitja për monitorimin e zbatueshmërisë të masave nga bizneset dhe shkollat të cilat do të rifillojnë aktivitetin në dt. 18 Maj. Këshillat bashkiakë në disa bashki (Pogradec, Korçë, Gramsh) përdorën komunikimin online (zoom, skype, whatsapp) për të ushtruar funksionin e tyre monitorues mbi administrimin e ndihmave tek qytetarët.

E-Ankesa: Në Berat qytetarët u inkurajuan të depozitonin ankesat nëpërmjet email-eve. Në shumë bashki u përdor komunikimi në "chat" me numrat e gjelbër në Whastapp për çdo nevojë. Në Bashki të tjera (Kukës, Lezhë, Korçë) u përdorën formularë online për të kërkuar ndihmë apo për tu ankuar mbi ndonjë çështje që lidhej me administrimin e masave anti Covid.

E-Shërbime: Pengimi i lëvizjeve gjatë pandemisë krijoi nevojë që bashkitë të vënë në dispozicion mundësi të reja për ofrimin e disa shërbimeve. Për t'i ardhur në ndihmë pleqve të vetmuar apo grave të dhunuara në Tiranë dhe Lezhë u përdorën aplikacione të dedikuara për të adresuar këto nevoja. Në fillim të Majit 26 bashki shpërndanë tek prindërit e fëmijëve 3-6 vjeç video informuese për përdorimin e shërbimit të psikologut nëse do të ishte i nevojshëm. Falë kësaj fushate janë 43 fëmijët të cilët kanë përdorur këtë shërbim në qarqet Durrës, Kukës, Lezhë.

DREJT HAPJES

Bashkitë janë duke u përgatitur për të mundësuar hapjen e shërbimeve sipas orientimit nga Qeveria Qendrore. Në bashkitë që priten të ardhurit përtej kufijve, janë mbyllur qendrat e përshtatura për akomodimin e tyre. Një impenjim i konsiderueshëm është vënë re nga bashkitë për të dezinfektuar shkollat si dhe për të ofruar mjete për mbrojtjen personale për nxënësit e shkollave. Në Vlorë bashkia e ka shtrirë procesin e dezinfektimit deri tek universiteti. Në bashkitë ku ka administratorë pallati është koordinuar me ta për të bërë dezinfektimin e ambienteve të përbashkëta.

Për të lehtësuar bizneset bashkitë kanë aplikuar lehtësira fiskale në formën e shtyrjes së taksës apo uljes së përkohshme të tarifave, si pagesa për hapësirën publike. Bashki si ajo e Vlorës apo Pogradecit të cilat janë afektuar nga protokollet e COVID-19 kanë rishikuar taksat dhe tarifën duke i rilogaritur ato. Disa bashkitë kanë lehtësuar detyrimet e shtresave vulnerabël në drejtim të banesave sociale duke i falur ose shtyrë ato. Një task forcë për inspektimin e e zbatimit të masave për covid-19 është ngritur nga Inspektoriati Shtetëror Shëndetsor, Agjencia Kombëtare e Ushqimit, Inspektoriati I Punës, Drejtoria Tatimore dhe policia. Ky task force I ngritur do të monitorojë masat në bashkitë e vendit dhe do të koordinohet nga institucioni I prefektit. Ky monitorim për ruajtjen e distancave sociale, sidomos në biznese si bare dhe restorante do të bëhet me anë të një formulari "Google Form" . Prej 18 majit fashat orare të reduktura do të hiqen dhe adminstrata do të rikthehet në orarin e plotë zyrtar.

TURIZMI

Me lehtësimin e regjimit të masave për Covid-19, bashkitë janë përpjekur të organizojnë përgatitjen për çeljen e sezonit të ri turistik. Disa bashki kanë krijuar video për të risjellë vëmendjen tek atraksionet turistike si natyrore dhe ato kulturore që gjenden brenda kufijve bashkiak. Mundësia që kufijtë mund të vazhdojnë të qëndrojnë të mbyllur me zonën Shengen, ka bërë që bashkitë, bazuar edhe në diskutimet e Qeverisë Qendrore ka tendenca për orientim drejt pritjes së turizmit patriotik dhe atij që është emërtuar "Shengen ballkanik". Ky sektor është shumë i rëndësishëm për buxhetet e bashkive pasi në shkallë vendi në 2019 ky sektor kontribuoi 10.4% të PBB.¹ Në zonat me turizëm malor janë zhvilluar mbledhje me sektorin e turizmit për të diskutuar mbi mundësitë që mund të krijohen prej natyrës së këtij lloji turizmi I cili mund t'i përshtatet më lehtë nevojës për distancim. Në zonat me turizëm masiv bregdetar krahas përgatitjeve infrastrukturore bashkitë kanë konsideruar uljen e disa tarifave dhe taksave bashkiake. Në Sarandë kryetari I bashkisë I ka sugjeruar operatorëve turistik të bëjnë oferta 20% më të lira se zakonisht për të thithur turistin vendas.

PËRGJIGJA E BASHKISË NDAJ SHTRESAVE MË SHUMË TË AFEKTUARA

Bashkitë u angazhuan në shpërndarjen e ndihmës ushqimore për shtresat më vulnerabël dhe në disa raste asistuan edhe financiarisht persona të pa përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike para emergjencës².

¹ Të dhëna të marra nga World Travel & Tourism Council "2019 ANNUAL RESEARCH

² 400 persona të komunitetit Rom u përfshinë në skemën e ndihmës ekonomike për periudhën e Covid-19

Policia bashkiake krahas asaj të shtetit monitoruan lëvizjet dhe respektimin e rregullave për distancim social. Në kuadër të masave parandaluese, bashkitë morën masa për ofrimin e shërbimit edhe në kushtet e reja. Në qytete të mëdha si Tirana dhe Vlora u krijuan vende të reja për tregtim të produkteve ushqimore dhe atyre bujqësore. Disa nga masat e mara në bashkitë e mëdha u replikuan dhe tek të tjerat siç ishte rasti i tuneleve të dezinfektimit. Në disa bashki të tjera tregjet u zhvendosën nga vendet e tyre tradicionale në vendndodhje ku shmangej grumbullimi. Në Devoll po ndërtohet një treg me dy kate për të strehuar tregtarët e produkteve bujqësore. Të gjitha bashkitë u angazhuan në shpërndarjen e ndihmave për shtresat në nevojë dhe një pjesë bëri dhe rialokime financiare me këtë qëllim.

40 bashki u angazhuan pas firmosjes së rezolutës kundër dhunës në familje, ku komisionet e barazisë gjinore kanë filluar të monitorojnë punën e bashkisë në këtë drejtim. Në Vlorë, Kukës, Kuçovë janë marrë masa për asistimin disa rasteve ku gratë kanë patur nevojë për strehim dhe mbrojtje të garantuar.

EMERGJENCAT CIVILE

Shoqata për Autonominë Vendore (SHAV), me mbështetje të projektit Bashki të Forta (BtF), po kryen një vëzhgim të kapaciteteve institucionale ekzistuese dhe nevojave të Njësive të Qeverisjes Vendore lidhur me zbatimin e funksionit të mbrojtjes civile. Një pyetësor i përgatitur nga ekspertët e projektit i është dërguar të gjitha bashkive. SHAV ka organizuar një vëzhgim duke zhvilluar intervista me individë dhe fokus grupe me Kryetarë dhe nënkryetarë të bashkive si dhe specialistë të strukturave për mbrojtjen civile në periudhën Prill-Maj 2020.

Ky studim u bë me qëllim kuptimin e kapaciteteve institucionale të NJQV mbi funksionin e mbrojtjes civile duke marrë shkas nga eksperiencat e viteve të fundit në menaxhimin e situatave të emergjencave civile dhe impakti ekonomik dhe social si pasojë e fatkeqësive natyrore.

Gjetjet paraprake të studimit evidentuan se bashkitë kanë (i) ngritur strukturat për mbrojtjen civile, por nuk ka një standard, në bashki të ndryshme është i ndryshëm (ii) fondi prej 4% i buxhetit të bashkisë si transfertë nga qeveria nuk është bërë efektiv, (iii) baza materiale e strukturave është pjesërisht e amortizuar dhe investime janë të nevojshme, (iv) bashkitë nuk kanë hartuar ende dokumentin e vlerësimit të riskut, (v) është i nevojshëm ngritja e një sistemi të mbrojtjes civile me protokolle të standardizuar të procedurave dhe sistem të njoftimit të hershëm sipas rregullave të BE dhe praktikave më të mira; investimet parandaluese në bazë të vlerësimit të riskut janë të nevojshme për të reduktuar dëmet ekonomike në rast të fatkeqësive natyrore.